

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6921
E mërkurë, 14 qershor 2023
Çmimi 0.40 €

Kosova më pak nxënës
dhe studentë sesa
një vit më parë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI MBAN KONFERENCË PËR MEDIE | FAQE 4-5

KURTI, PLAN PESËPIKËSH PËR QETËSIMIN E SITUATËS NË VERI



Në lidhje me situatën në veri kryeministri Albin Kurti i ka takuar të martën përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Quint-it dhe të Bashkimit Evropian. Në këtë takim të tyre u

diskutua për procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë në kuptim të zbatimit të plotë dhe të pakushtëzuar të Marrëveshjes Bazike dhe masave të qetësimit të situatës

në katër komunat në veri. Kurti i informoi ambasadorët dhe zëvendësambasadorët për propozimin e tij pesëpikësh për qetësimin e situatës në veri

AKTUALE



MILIARDERI GEORGE SOROS
IA KALON DJALIT MË TË VOGËL
KONTROLLIN E BIZNESIT | F. 2

PRESIDENTJA OSMANI SOT FLET
NË PARLAMENTIN EVROPIAN | F. 5

RRGK, TEJET E SHOQËTËSUAR
PËR SULMIN SEKSUAL NDAJ TË
MITURËS NË NJË SHKOLLË
NË DEÇAN | F. 7

EKONOMI



MENAXHIMI I "PARKUT
KOMBËTAR" TË VJOSËS, PLANI DO
TË SJELLË DISA KUFIZIME NË
BUJQËSI DHE TURIZËM | F. 8

SPORT



KLUBET E INKUADRUARA NË
SUPERLIGË I NDAJNË RRUGËT
ME TRAJNERËT | F. 10

**ARRESTIMI I
MILLENKOVIQIT
DHE HESHTJA E
PROKURORISË
PËR "LISTËN"
E KURTIT** | FAQE 3



**MBAHET
PUNËTORIA
PËR
ZHVILLIMIN
EKONOMIK
LOKAL** | FAQE 8



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Miliarderi George Soros ia kalon djalit më të vogël kontrollin e biznesit

NJU-JORK, 13 QERSHOR - Miliarderi George Soros ia dha kontrollin e kompanisë me vlerë prej 25 miliardë dollarësh djalit të vet më të vogël, Alexander Soros, i cili konfirmoi vendimin në një intervistë për gazetën "The Wall Street Journal".

Pronat e biznesit të Sorosit përfshijnë Fondacionin e tij jofitimprurës për Shoqëri të Hapur, i cili e ushtron aktivitetin në më shumë se 120 vende anembanë botës. Sipas të dhënave të publikuara në faqen e internetit të Fondacionit për Shoqëri të Hapur, organizata jep rreth 1.5 miliardë dollarë në vit për grupet që mbështetin të drejtat e njeriut dhe nxitin rritjen e demokracive në

mbarë botën.

37-vjeçari Alexander Soros tha se ai është "më politik" se babai i tij 92-vjeçar, i cili ka qenë në shënjestër të kritikave të krahut të djathtë për mbështetjen e tij të kauzave liberale, si pakësimi i paragjyqimeve racore në sistemin e drejtësisë. Por ai vuri në dukje se ata kanë "pikëpamje të ngjashme" për shumë çështje.

Alexander Soros tha se ai po zgjeronte "qëllimet liberale" të babait të tij dhe po mbështeste çështje të ndryshme, duke përfshirë të drejtën e votimit, abortin dhe barazinë gjinore. Ai tha se synon të vazhdojë ta përdorë pasurinë e familjes për t'i mbështetur politikanët amerikanë

me prirje të majta.

Alexander Soros tha për gazetën "Wall Street Journal" se së fundmi është takuar me zyrtarë të administratës Biden, udhëheqësin e shumicës në Senat, Chuck Schumer dhe krerë shtetesh, duke përfshirë presidentin e Brazilit, Luiz Inácio Lula da Silva dhe kryeministrin e Kanadasë, Justin Trudeau, për t'i nxitur çështjet që lidhen me themelet e familjes.

Në dhjetor, bordi i Fondacionit të Shoqërisë së Hapur zgjodhi Alexander Sorosin në pozitën e kryetarit të tij, duke zëvendësuar babanë e tij.

Alexander Soros tani drejton edhe aktivitetin politik si president i organizatës politike "Soros".



Presidenti polak kërkon anëtarësimin e Ukrainës në NATO

VARSHAVË, 13 QERSHOR - Presidenti polak Andrzej Duda u ka bërë thirrje vendeve anëtare të NATO-s që t'i japin Kievit një udhërrëfyes të qartë për t'u bashkuar me Aleancën. "Ukraina është duke pritur për një sinjal të qartë në lidhje me një perspektivë të qartë të anëtarësimin në NATO", tha Duda më 12 qershor pas një takimi me presidentin francez Emmanuel Macron dhe kancelarin gjerman Olaf Scholz në Paris.

Takimet trepalëshe që përfshijnë Gjermaninë, Francën dhe Poloninë, të njohura si Trekëndëshi i Vajmarit, filluan në vitin 1991 në Vajmar të Gjermanisë. Fillimisht, bisedimet synuan ta sillnin Poloninë dhe shtetet e tjera të Evropës Lindore më afër Bashkimit Evropian dhe NATO-s.

Gjermania në muajin prill e ka miratuar kërkesën e Polonisë për t'i eksportuar pesë avionë të vjetër



luftarakë të llojit MiG-29 për ta forcuar fuqinë ajrore të Ukrainës

kundër pushtimit rus. Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris

Pistorius, tha se kërkesa kishte mbërritur të enjten dhe se

miratimi i kërkesës në po të njëjtën ditë nga Berlina tregon se të tjerët mund të mbështeten në Gjermaninë.

Gjermania i trashëgoi 24 avionë të llojit MiG-29 nga ish-Gjermania Lindore pas ribashkimit në vitin 1990. Në atë kohë ky lloj i avionit cilësohej si një ndër avionët luftarakë më të avancuar në botë. Në vitin 2004 Berlina ia dërgoi 22 avionë të tillë Polonisë. Nga dy avionët e mbetur në ushtrinë gjermane, një u shkatërrua gjatë një përplasjeje dhe një është në një ekspozitë në një muze.

Polonisë i nevojitet paraprakisht miratimi nga Berlina zyrtar për t'i dërguar këta avionë në një vend tjetër.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha gjatë një vizite në Varshavë se Polonia do të ndihmojë në formimin e një koalicioni të fuqive perëndimore për ta furnizuar Ukrainën me avionë luftarakë.

Zelensky zotohet se do të marrë masa për përmirësim të strehimoreve

KIEV, 13 QERSHOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, shprehu pakënaqësi të hënën për rezultatet e një inspektimi që kishte urdhëruar në të gjitha strehimoret ukrainase, pasi tre persona humbën jetën pasi ishin në gjendje të genin strehë gjatë një sulmi ajror rus në Kiev.

Në adresimin e tij të natës përmes një paraqitjeje me video, Zelensky tha se kishte marrë raporte përmblendhëse mbi "gatishmërinë dhe papërgatitjen" e strehimoreve nga ministri i Brendshëm Ihor Klymenko, ministri për Industrinë Strategjike Oleksandr Kamyshtyn, dhe zëvendëskryeministri

Oleksandr Kubrakov. "Rezultatet, ta them sa më butë, janë të pakënaqshme. Deri të premtën do të përgatiten projektvendimet përkatëse në lidhje me përgjegjësit dhe sigurimin e nivelit të duhur të mbrojtjes për njerëzit tanë në të gjitha qytetet e Ukrainës", shtoi Zelensky.

Vdekjet që ndodhën më 1 qershor çuan në një reagim të fortë publik dhe shkaktuan një angazhim nga Zelensky për ta hetuar ngjarjen dhe strehimoret në mbarë Ukrainën.

Kjo përgjigje duket se i drejtohej kryebashkiakut të Kievit, Vitali Klitschko, me të cilin Zelensky ka pasur konflikte të mëparshme.

Klitschko pranoi se ai mbante njëfarë përgjegjësie, por tha se të tjerët ishin gjithashtu fajtorë, veçanërisht aleatët e presidentit që ishin caktuar për t'i udhëhequr rrethet e qytetit.

Më 4 qershor ministri Kamyshtyn raportoi se pothuajse 50 % e strehimoreve në Kiev, të cilat u ekzaminuan gjatë kontrollit fillestar, ose ishin mbyllur ose konsideroheshin të papërshtatshme për t'u përdorur.

Një vajzë nëntë vjeçe, nëna e saj dhe një grua tjetër, vdiqën në Kiev më 1 qershor, pasi gjatë sulmit u përpoqën të hynin në një strehimore, por ajo ishte e mbyllur.



Rama: Nuk mbahet mbledhja mes dy qeverive

Mbledhja mes qeverive të Kosovës dhe të Shqipërisë, e planifikuar për të mërkurën e 14 qershorit në Gjakovë, është anuluar.

Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama në një konferencë për media ka thënë se ka informuar Kurtin se në këto kushte, takimi nuk mund të mbahet në formatin e parashikuar.

“Në kushtet e përkeqësimit të marrëdhënies të Kosovës me krejt bashkësinë Euroatlantike, ky takim nuk mund të mbahet në formatin e parashikuar. I kam kërkuar Albinin që të takohemi në Gjakovë në një format më të ngushtë, përkatësisht me ministrat e mbrojtjes dhe të jashtëm”, ka deklaruar Rama.

Rama tha se për shkak të situatës në veri të Kosovës dhe përkeqësimit të raporteve të Prishtinës me aleatët perëndimor, takimi në Gjakovë nuk është i mundur të mbahet siç është paraparë sepse “nuk është një moment për të krijuar një pasqyrë të re me të asaj që në fakt ndodh në realitetin e Kosovës sot”.

“Për fat të keq edhe me shumë keqardhje më duhet të them se nuk kemi pasur dakordësi me Kurtin për një ndryshim të formatit dhe ka kërkuar që mbledhja të bëhet normalisht dhe pastaj veç të diskutojmë për këtë por kjo nuk është e mundur sepse nuk është një moment për të krijuar një pasqyrë të re me të asaj që ndodh me realitetin e Kosovës sot”, tha Rama.

“Mbase nuk është një përgjigje përfundimtare nga ana e kryeministrit, besoj shumë që të mund të takohemi, për të ballafaquar opinionet në kushtet kur përsëris jemi në prag të lëvizjes së planit, nuk ma zë goja të flas për sanksionet, por të masave shtrënguese ndaj shtetit që është krijuar nga ata që qartësisht janë në kushte të sosjes së durimit”, ka thënë ai.

Në këtë mbledhje ishte planifikuar takimi i kryetarëve të komunave të zonave kufitare në të dyja vendet, ku pritej të diskutoheshin që sfidat të kthehen në mundësi dhe mundësi në përfitim për qytetarët.

Ndryshe, zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, ka mohuar zërat për anulimin e mbledhjes së dy qeverive të Kosovës dhe Shqipërisë që është planifikuar të mbahet të mërkurën, 14 qershor, në



Gjakovë.

“Gjithçka është gati në Gjakovë. Kryeministri Kurti tani po merr pjesë në koncertin e sotëm atje të Ansambllit Shota dhe muzikantëve nga Kosova nga Shqipëria që është edhe uverturë për mbledhjen e nesërme”, ka thënë ai.

Mbledhja në Gjakovë pritej të

mbahej disa ditë pasi Rama ua ka dërguar një draft për Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë, presidentit të Francës, Emmanuel Macron, dhe kancelarit gjerman, Olaf Scholz. Rreth këtij propozimi, Kurti të martën në një konferencë për media ka thënë se Rama, në vend që të propozojë Asociacion për

serbët në Kosovë, le t’ia propozojë një të tillë Beogradit, për shqiptarët në Serbi.

Në mbledhjen e nëntë mes dy qeverive pritej të nënshkruheshin 13 marrëveshje në fusha të ndryshme: drejtësisë, arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, kulturës, ndërmarrësisë dhe mbrojtjes. Në mesin e tyre ishte edhe një

deklaratë për forcimin e bashkëpunimit mes dy shteteve në fushën e sigurisë.

Qeveria e Kosovës ka thënë paraprakisht se nga 41 marrëveshje të nënshkruara në dy mbledhjet pararendëse, 39 prej tyre janë zbatuar plotësisht e dy tjera janë në fazën finale të zbatimit.

Rama: Për Asociacionin, të painteresuar janë Kurti dhe Vuçiqi

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se deklarata e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, që e dha sot për draft-asociacionin të propozuar nga Rama, nuk ka ndikuar në vendimin për mos mbajtjen e mbledhjes së përbashkët të dy qeverive.

Ai, në një konferencë për media, ka thënë se Kurti dhe presidenti serbë, Aleksandar Vuçiq, nuk janë të interesuar për të formuar Asociacionin e komunave me shumicë serbe.

“Zero, sepse së pari përpjekja ime për t’u takuar me kryeministrin e Kosovës nuk ka nisur sot, ka disa ditë që i kam kërkuar

të takohemi, për të folur për këtë situatë. E dyta zero, sepse siç unë them atë që mendoj edhe Albini thotë atë që mendon për mua, për mua nuk ka surpriza, nuk ka gjëra të panjohura me Albinin sepse siç më njeh ai mua e njoh dhe unë atë, edhe është i sigurt në atë që thotë, ai beson në atë që thotë diçka të rëndësishme dhe diçka që unë duhet ta marr në konsideratë”.

“E fundit 0 sepse ka dy njerëz që janë të painteresuar për Asociacionin dhe në këtë pikë janë bashkë, jo janë bashkë ne kuptimin që janë marrë vesh, por në kuptimin që janë të interesuar që asociacioni të mos

krijohet këta janë kryeministri i Kosovës dhe presidenti i Serbisë. Pse? Sepse për mënyrën se si e kanë të ndërtuar politikën e tyre të brendshme u duhet armiku i jashtëm.

“Pse i çon presidenti serb ushtarët në kufi me Kosovën? Mendoni se në cepin e largët të mendjes dhe ëndrrën më kurajoze ai mendon se mund të futet një ushtar serb një metër në kufirin e Republikës së Kosovës? Absolutisht, as nuk e imagjinon po pse i qon, nuk i qon për të mbrojtur me armë serbët me armë që janë në Kosovë, por për të ndezur shpirtin nationalist serbëve. Për ca këndojnë ata,

për ca, këndojnë për ata që i dëgjojnë në Serbi, këngë mitingu, pa asnjë lloj lidhje, për ca i duhet Kosovës ky konfrontim me Serbinë”.

“Serbia e ka humbur luftën ushtarakisht njëherë e mirë në vitin 1999. Serbia qysh nga viti 1999 nuk është më kërcënim për Kosovën nuk ka çka i bënë fare, jo se është Kurti por sepse aty është Amerika, është kjo Amerikë e cila sot është në acarimin maksimal me Qeverinë e Kosovës. Atëherë për çfarë duhet kjo histori konfrontimi permanent duhet për politikë të brendshme”, ka thënë Rama.

Rama paralajmëron ‘plan shumë të rëndë’ për Kosovën nga Perëndimi

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se mund të ketë masa shtrënguese ndaj Kosovës, pas situatës që është krijuar në veri të vendit.

Rama, në një konferencë të jashtëzakonshme, ka potencuar se ka kërkuar kohë që mos të bëhen këto masa.

“Jemi në prag të vënies së

lëvizjes së planit, jemi në prag të vënies në fjalë, nuk ma zë goja fjalën sanksione, por të masave shtrënguese të një shteti që është krijuar nga ata që

janë në kushte të sosjes së durimit. Kam bërë një përpjekje ku kam kërkuar edhe pak kohë, por nëse nuk e shfrytëzon këtë kohë për një sens të

përbashkët mes të gjithëve, kam frikë se plani që është një plan realisht shumë i rëndë për Kosovën do të vjen lëvizja”, ka deklaruar Rama.

Arrestimi i Millenkoviqit dhe heshtja e Prokurorisë për “listën” e Kurtit



Prishtinë, 13 qershor - Millun Millenkoviq u arrestua pasditen e 13 qershorit nën dyshimet se ka organizuar sulme kundër ushtarëve të misionit të NATO-s, KFOR, në Zveçan, komunë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Tensionet në këtë zonë janë të larta qysh në fund të muajit maj, kur kryetarët shqiptarë të komunave atje hynë në objektet komunale, që shfrytëzohen edhe nga autoritetet paralele serbe. Situata u përshkallëzua në përlëshje të dhunshme në mes të protestuesve serbë dhe ushtarëve të KFOR-it si dhe Policisë së Kosovës.

Në një seancë të Kuvendit të Kosovës, më 2 qershor, kryeministri i vendit, Albin Kurti, përmendi emrat e disa personave që, siç tha, bartin përgjegjësi për organizim dhe shkaktim të dhunës në veri, por jo edhe atë të Millenkoviqit.

Kurti, ndërkohë, kritikoi Prokurorinë e vendit për “mosveprim”, por ajo nuk e komentoi listën e tij me emra. Për dhunën në Zveçan, më 29 maj,

më herët janë arrestuar pesë persona, por Gjykata Themelore në Prishtinë caktoi paraburgim prej një muaji vetëm për dy prej tyre.

Kush është Millun Millenkoviq?

“I njëjti ka qenë edhe organizator kryesor i sulmeve ndaj forcave të KFOR-it dhe Policisë së Kosovës në Zveçan”, tha Sveçla. Aksioni i Policisë së Kosovës për arrestimin e tij u zhvillua në Mitrovicë të Veriut.

Për aktivitetet e Millenkoviqit në internet nuk ka shumë informacione publike. Merret vesh se ai është trajner i Klubit të Kikboksit “Kosovska Mitrovica” (“Mitrovica e Kosovës”) dhe se ka marrë pjesë në emisione televizive në Serbi.

Sipas intervistave që ka dhënë Millenkoviq, ky klub e ka bazën në pjesën veriore të Kosovës dhe ka më shumë se 100 anëtarë.

Në fotografi të ndryshme të garave sportive, Millenkoviq bashkë me sportistë të tjerë shihen me flamujt ku shkruan

“Kosova është Serbi”.

Kjo thirrje është shkruar edhe nëpër hapësira të ndryshme publike në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - bashkë me thirrje të ngjashme për kundërshtimin e autoriteteve të Kosovës.

Çfarë tha Kurti pak para arrestimit të Millenkoviqit?

Pak kohë para se të arrestohej Millenkoviq, kryeministri Kurti kritikoi ashpër Prokurorinë e Kosovës. Ai tha se nuk e kupton mosveprimin e saj pasi, siç u shpreh, ekzistojnë qindra fotografi e videoincizime në të cilat shihen personat që sulmuan ushtarët e KFOR-it si dhe Policinë e Kosovës. “Unë edhe më tej nuk e kuptoj Prokurorinë tonë të Shtetit. Nuk e kuptoj se si është e mundur që, përkundër qindra fotografive e videoharrimeve të shkeljeve të ligjit e të krimeve e të denoncimeve me emër e mbiemër të të gjithë atyre

personave, nuk ka veprime nga Prokuroria jonë”, tha Kurti.

Ai, po ashtu, e cilësoi të çuditshëm faktin që Prokuroria, nga dhjetori i vitit të kaluar, nuk ngriti asnjë aktakuzë për personat që vendosën barrikada në rrugët në veri. Grupe serbësh lokalë u rebeluan në atë kohë për shkak të një vendimi të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa serbe në targa të Republikës së Kosovës.

Prokuroria nuk e komenton “listën” e Kurtit

Prokuroria Speciale e Kosovës nuk dha asnjë informacion sa i takon hetimit të personave të dyshuar për organizim dhe kryerje të dhunës në veri, as për rastin Millenkoviq.

Nga data 8 qershor, REL-i shkëmbeu mesazhe me Prokurorinë, por nga ky institucion nuk dhanë detaje nëse janë duke u hetuar emrat që i bëri publikë Kurti, e që tha se janë përgjegjës për dhunën. Sipas Kurtit, udhëheqës i grupit të armatosur

që sulmoi KFOR-in ishte ish-kapiteni i Policisë së Kosovës, Aleksandar Filipoviq. “Personat që po i shohim të maskuar në video dhe nëpër fotografi janë të udhëhequr nga ish-kapiteni i Policisë së Kosovës, Aleksandar Filipoviq, që shtirej sikur është integruar në shtetin tonë”, tha Kurti më 2 qershor.

Filipoviq, ashtu si edhe pjesëtarë të tjerë serbë të Policisë së Kosovës, dhanë dorëheqje në nëntor të vitit të kaluar, në shtetë pakënaqësie me vendimin për reregjistrimin e makinave.

Pak kohë më vonë Filipoviq u shpërblye me “Medaljen e Artë për Guxim - Millosh Obiliq” nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Duke u bazuar në të dhënat e një institucioni të sigurisë në Kosovë, REL raportoi më 12 maj se Filipoviq ka qenë në një takim në ambientet e Agjencisë së Informacionit (BIA) në Beograd më 10 maj. Po sipas këtij raporti, Filipoviq ka pasur rol në hapjen e zyrave të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në Mitrovicën e Veriut.

Aliu takon kryetarin e Leposaviqit, i ofron përkrahje në projektet infrastrukturore

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka takuar të martën kryetarin e komunës së Leposaviqit, Lulzim Hetemi. Ai ka bërë me dije se me kryetarin Hetemi kanë

diskutuar për bashkëpunimin e ndërsjellë për realizimin e projekteve që do të kontribuojnë në zhvillim ekonomik për të gjithë qytetarët, respektivisht për projekte infrastrukturore në këtë komunë, me ç’rast Aliu i ka ofruar mbështetje të

parezervë. “E falënderoj kryetarin Lulzim Hetemi nga zemra për qëndresën e tij shembullore për Republikën e Kosovës si dhe Policinë e Kosovës për disiplinën dhe profesionalizmin e pashembullt që po e tregojnë për çdo ditë”, ka thënë Aliu.





KRYEMINISTRI ALBIN KURTI MBAN KONFERENCË PËR MEDIE

Kurti, plan pesëpikësh për qetësimin e situatës në veri

Në lidhje me situatën në veri kryeministri Albin Kurti i ka takuar të martën përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Quint-it dhe të Bashkimit Evropian. Në këtë takim të tyre u diskutua për procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë në kuptim të zbatimit të plotë dhe të pakushtëzuar të Marrëveshjes Bazike dhe masave të qetësimit të situatës në katër komunat në veri. Kurti i informoi ambasadorët dhe zëvendësambasadorët për propozimin e tij pesëpikësh për qetësimin e situatës në veri

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, i kanë takuar të martën përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Quint-it dhe të Bashkimit Evropian. Në takimin e tyre është diskutuar për procesin e

normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë në kuptim të zbatimit të plotë dhe të pakushtëzuar të Marrëveshjes Bazike dhe masave të qetësimit të situatës në katër komunat në veri të Kosovës. Kryeministri Kurti në këtë takim ka theksuar se është i gatshëm të marrë pjesë në një takim të nivelit të lartë në Bruksel në të cilin do të diskutohej një sekuencim i drejtë, i balancuar dhe gjithëpërfshirës i

zbatimit të Marrëveshjes Bazike. Ai i ka informuar ambasadorët dhe zëvendësambasadorët e pranishëm për bisedën që ka pasur një ditë më parë me përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, gjithashtu edhe për propozimin pesëpikësh për qetësimin e plotë të situatës në katër komunat në veri të vendit.

Plani i tij parashihet pesë pika që, sipas tij, ndihmojnë në ulje të tensioneve: përmbushjen e ndjekjes penale dhe gjykimin e kriminelëve që sulmuan Policinë e Kosovës, KFOR-in dhe gazetaret; ndërprerjen e menjëhershme të sulmeve të grupeve të dhunshme kundër institucioneve legjitime në raport me të cilën do të mund të bëhej zvogëlimi i pranisë së policisë në objektet komunale; vlerësimet e përbashkëta të sigurisë në mes të Policisë së Kosovës, KFOR-it dhe EULEX-it çdo pesëmbëdhjetë ditë për të garantuar një ambient të sigurt për të gjithë; koordinim ndërmjet qeverisë dhe të gjithë aktorëve për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të cila duhet të organizohen në një atmosferë të

lirë, demokratike dhe të papenguar liberale; rikthimin e menjëhershëm në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, teksa ky i fundit siguron një plan të sekuencimit të drejtë dhe të balancuar të zbatimit të Marrëveshjes Bazike dhe Aneksit të saj.

Kryeministri Kurti, pas takimit me përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Quint-it, ka mbajtur një konferencë për medie. Ai ka treguar se këtë propozim e ka ndarë paraprakisht me kryediplomatën evropian Josep Borell. "Me Borrellin dhe, dhe vendet partnere të Quint-it sot, e kam shprehur përkushtimin dhe angazhimin e plotë të qeverisë për uljen e tensioneve në veri dhe për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë".

Ambasada e Gjermanisë: Nuk e kemi bojkotuar pritjen shtetërore për Ditën e Çlirimit

Prishtinë, 13 qershor - Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë tha se "nuk e kemi bojkotuar" pritjen zyrtare të organizuar nga Presidenca dhe Kryeministria për Ditën e Çlirimit më 12 qershor.

Më 12 qershor ambasadorët e shteteve të Quint-it (Shtetet e Bashkuara, Gjermania, Italia, Franca dhe Britania e Madhe) nuk janë parë në ngjarjen e organizuar

nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri Albin Kurti, për shënimin e 24-vjetorit të çlirimit të Kosovës.

Mediet në Kosovë kanë raportuar se ambasadorët e shteteve të Quint-it e kanë bojkotuar këtë ngjarje. "Ambasada gjermane ka pranuar ftesë për të marrë pjesë në këtë ngjarje dhe zyrtarisht në të është përfaqësuar nga zëvendës-kreu i

misionit, siç ka ndodhur në shumë raste", thanë për "Radio Evropë e Lirë" nga Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë. Megjithatë, kjo ambasada nuk pranoi të japë detaje se pse ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, nuk mori pjesë në pritjen zyrtare.

"Radio Evropë e Lirë" ka dërguar pyetje edhe në ambasadat e tjera të vendeve të Quint-it, por ende nuk

ka marrë përgjigje.

Kjo mosmarrje pjesë e ambasadorëve të shteteve të Quint-it në këtë ngjarje vjen në kohën kur bashkësia ndërkombëtare po i kërkon Qeverisë së Kosovës ta qetësojë situatën në veriun e banuar me shumicë serbe. Deri më tani ekzekutivi në Kosovë nuk i ka plotësuar kërkesat e partnerëve ndërkombëtarë.

Atje, që nga 26 maji, tensionet janë rritur, pasi kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri hynë në ndërtesat komunale, nën përcjelljen e policisë, pavarësisht prej kundërshtimit të serbëve lokalë.

Që nga 29 maji serbët lokalë po protestojnë vazhdimisht në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.



Presidentja Osmani sot flet në Parlamentin Evropian

Prishtinë, 13 qershor - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, me ftesë të presidentes së Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, do t'i drejtohet Parlamentit Evropian këtë të mërkurë. Kjo është hera e parë që një president i Republikës së Kosovës shtet i pavarur do të paraqitet në seancën plenare të Parlamentit Evropian. Presidentja Osmani do t'u adresohet deputetëve të

Parlamentit Evropian lidhur me arritjet e Kosovës dhe rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ajo do ta shprehë mirënjohjen e qytetarëve të Kosovës për përkrahjen që Parlamenti Evropian ka ofruar për Kosovën që nga vitet '90. Gjatë qëndrimit në Strasburg, ku po mbahet seanca e Parlamentit Evropian, presidentja Osmani do të pritë fillimisht nga presidentja e Parlamentit

Evropian, Roberta Metsola, për të diskutuar për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe këtij institucioni, pastaj do t'i takojë edhe udhëheqësit e grupeve kryesore politike të përfaqësuar në Parlamentin Evropian.

Përveç takimeve me përfaqësues të Parlamentit Evropian, gjatë qëndrimit në Strasburg, presidentja Osmani do të takojë edhe përfaqësues të Këshillit të Evropës.



Vendet e Quint-it janë: Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia.

Ai ka thënë se situata në veri nuk është normale për një kohë të gjatë. "Eskalimi më 29 maj e bën urgjente sjelljen para drejtësisë të të gjithë atyre që ushtruan dhunë ndaj Policisë së Kosovës, ushtarëve të NATO-s dhe jui gazetarëve", ka thënë Kurti. Ai u është referuar përlëshjeve të 29 majit në Zveçan në mes të protestuesve serbë dhe pjesëtarëve të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Serbët lokalë janë duke protestuar vazhdimisht prej asaj dite për ta

kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale.

Komuniteti ndërkombëtar i ka tri kërkesa për kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, lidhur me situatën në veri: shtensionimin e situatës atje; mbajtjen e zgjedhjeve të reja; kthimin në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Kurti ka thënë se është i interesuar për mbajtje të zgjedhjeve të reja por, sipas tij, nuk nevojitet nxitim "për të një dështim të ri". Ai ka thënë se nuk dëshiron ta caktojë datën e

zgjedhjeve, por dëshiron që të analizohen të gjithë skenarët. "Jam i interesuar që të ketë zgjedhje të reja në veri. E kuptoj që dalja ka qenë e ulët. Legjitimiteti është larg prej të qenët tamam në ato komuna. Mirëpo, ata të tjerët nuk kanë fare legjitimitet. Duhet një proces i ri zgjedhor".

Kurti: Rama draft-statutin t'ia paraqesë Vuçiqit për shqiptarët në Luginë

Në konferencë për medie, Kurti është pyetur edhe rreth propozimit të kryeministrit të

Shqipërisë, Edi Rama, për formim të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Kurti ka thënë se Rama, në vend se të propozojë asociacion për serbët në Kosovë, le t'ia propozojë një të tillë Beogradit për shqiptarët në Serbi. "Nuk kam dyshim që kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, beson se propozimi i tij i draft-statutit është i mirë, dhe duke qenë kështu, krejt çfarë unë propozoj është që kryeministri Rama këtë draft-statut për pakicat kombëtare t'ia paraqesë presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më së largu, në takimin e radhës të Ballkanit të Hapur, për

shqiptarët në Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc", është shprehur Kurti.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë më 8 qershor se ua ka dërguar një draft për asociacionin presidentit të Francës, Emmanuel Macron, edhe kancelarit gjerman Olaf Scholz. Rama ka thënë se dokumenti është konfidencial, por është shprehur i bindur se është "një dokument i nivelit më të lartë ndërkombëtar që merr në konsideratë të gjitha arsyet për krijimin e Asociacionit dhe që Asociacioni është pjesë e organizimit të jetës për Kosovën".

Rinovohet objekti i vjetër i QKMF-së në Rahovec

RAHOVEC, 13 QERSHOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me drejtoreshën e Shëndetësisë, Saranda Sallteku, kanë përfunduar përfundimin e renovimit të brendshëm të objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec.

Ky përfundim, që bëhet në kuadër të festimeve të çlirimit të Kosovës dhe në vigjilje të 14 qershorit, Ditës së Çlirimit të

Rahovecit, është dëshmi e përkushtimit institucional për përmirësimin e obligimeve ndaj dëshmorëve të lirisë.

Ky projekt përfshin renovimin e brendshëm të të gjitha reparteve, duke përfshirë: zgjerimin e korridoreve, rregullimin e dyshemesë, rregullimin e nyjave sanitare, vendosjen e dyerve dhe të dritareve të reja, vendosjen e ashensorit të ri, instalimin e ujësjellësit, kanalizimin dhe

rrjetin elektrik.

Me këtë investim stafi shëndetësor do të ketë kushte më të mira për punë dhe pacientët do të kenë shërbime më efikase.

Vlera e këtij investimi është 459.853.59 euro.

Investimet e kësaj natyre do të vazhdojnë edhe në pjesën e jashtme të objektit, me qëllim të ofrimit të kushteve më të mira për qytetarët tanë.



Në mungesë kuorumi, dështon sërish seanca e pestë e Kuvendit Komunal të Gjilanit

GJILAN, 13 QERSHOR - Kuvendi Komunal i Gjilanit, në mungesë kuorumi, nuk ka mundur ta vazhdojë as të martën seancën e pestë, për të katërtën herë radhazi.

Arianit Sadiku, kryesues i Kuvendit, ka thënë se si duket opozita ka vendosur ta vazhdojë bojkotimin e kësaj seance, kështu që për mungesë kuorumi seanca shtyhet për një datë tjetër.

Në seancë kanë marrë pjesë 16 anëtarë të Kuvendit, përfshirë edhe tre nga opozita (AAK, Vatra, LS) si dhe një anëtare e PDK-së, derisa 19 të tjerë nga LDK-ja e



PDK-ja kanë munguar. Siç dihet, para disa ditësh, partneri kryesor qeverisës, LV-ja, i dha fund koalicionit me PDK-në.

Shkas për këtë u bënë tri vendime të mëhershme që kanë të bëjnë me plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore në zonën e Bllokut "B3" në kuadër të Planit Rregullues Urban "Kodra e Thatë", në zonën e Bllokut "B4" në kuadër të Planit Rregullues Urban "Kodra e Thatë" dhe në zonën e Bllokut "I" në kuadër të Planit Rregullues Urban "Livadhet e Arapit", të cilat janë rikthyer në Kuvend për anulim, si të kundërligjshme.

Shfuqizimin e këtyre vendimeve e ka kundërshtuar opozita (LDK), me arsyetimin se nuk ka asnjë arsye për t'i anuluar, ndërkaq partneri i deridjeshëm i koalicionit (PDK) kishte kërkuar më shumë kohë e konsulta për këtë çështje.

Opozita (LDK, Vatra) e kishte lëshuar sallën, ndërkaq asamblistët e PDK-së nuk u kthyen në mbledhje pas pauzës që kishin kërkuar për konsultime. LDK-ja e PDK-ja (tani opozitë) nuk u paraqitën as të martën në vazhdimin e seancës, e cila dështoi për mungesë kuorumi.



Shërbimi shtëpiak, një nga shërbimet e rëndësishme shëndetësore në komunën e Drenasit

DRENAS, 13 QERSHOR - Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Drenas, Lumnije Krapit, ka vizituar shërbimin kronik-paliativ, i cili vazhdon dhënien e shërbimeve 12 orë në 7 ditë të javës për të gjithë qytetarët e Drenasit të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të marrin shërbime në institucione të

kujdesit parësor shëndetësor.

Ekipi i shërbimit shtëpiak dhe paliativ, i cili çdo ditë të javës është në dispozicionin të qytetarëve, mbetet i përkushtuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në terren. Vetëm gjatë muajit maj ky shërbim ka ofruar 965 vizita dhe 1 439 shërbime në terren.

Imri Hoxha zgjedhet kryetar i nëndegës së PDK-së në Strasburg

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Themelimi i nëndegëve dhe degëve të PDK-së nëpër mërgatë po vazhdon. Së fundmi, në prani të një numri të madh aktivistësh, është themeluar edhe nëndega e PDK-së në Strasburg të Francës.

Kryetar i saj me shumicë votash është

zgjedhur Imri Hoxha.

Në këtë Kuvend Zgjedhor ka marrë pjesë edhe deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra. "Themelimi i nëndegës së PDK-së në këtë qytet i jep zë angazhimit të mijëra mërgimtarëve tanë atje", ka thënë Deliu-Kodra.



Vazhdojnë punimet në rrethrotullimin e ri dhe të trotuareve në rrugën "Ekrem Rexha" në Prizren

PRIZREN, 13 QERSHOR - Me dinamikë të shtuar po vazhdon ndërtimi i rrethrotullimit të ri dhe trotuareve në rrugën "Ekrem Rexha" (ish-rruga "Tirana"),

në afërsi të Urgjencës së qytetit në Prizren.

Kryetari Shaqir Totaj ka thënë se pas përfundimit të këtij rrethrotullimi do të ndërtohen rrugë alternative.

"Punimet priten të përfundojnë para afatit të paraparë, marrë parasysh frekuentimin e madh të veturave në këtë rrugë. Pas përfundimit të këtij

rrethrotullimi do të ndërtohen rrugë alternative, që do t'i lidhin lagjet e kësaj zone dhe do ta lehtësojnë komunikacionin në Prizren", ka bërë me dije Totaj.



RrGK, tejet e shqetësuar për sulmin seksual ndaj të miturës në një shkollë në Deçan

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dënon ashpër incidentin e fundit të sulmit seksual ndaj një të miture nga arsimtari i saj në një shkollë fillore në Deçan. "Jemi thellësisht të shqetësuar dhe të indinjua nga një shkelje kaq e rëndë e besimit dhe e sigurisë së vajzave tona të reja. Ky akt i tmerrshëm i sulmit seksual shërben si një kujtesë e

fortë se ne duhet t'i japim përparësi mbrojtjes së vajzave dhe të miturve brenda shoqërisë sonë, madje edhe brenda në shkolla. Është koha e fundit që shoqëria dhe institucionet të marrin qëndrim kundër këtyre krimeve dhe të sigurojnë që autorët ta marrin dënimin e merituar, pa asnjë kompromis", është thënë në reagimin e

RrGK-së. Më tej theksohet në reagim se është dëshpëruese të shohësh që këto sulme ndaj vajzave ndodhin pikërisht para syve tanë, ndërkohë që institucionet shpesh nuk arrijnë ta japin drejtësinë dhe masat e duhura parandaluese. "Ngjarja në institucionin arsimor, ku nxënësit duhet të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur, nxjerr në

pah një situatë alarmante. Nuk mund të mos pyesim veten se sa raste të tjera nuk raportohen. RrGK u bënë thirrje institucioneve përgjegjëse që këtë rast ta trajtojnë si çështje me prioritet të madh, ashtu siç duhet çdo rast tjetër të ngacmimit dhe sulmit seksual. Shkollat, në veçanti, urgjentisht duhet të krijojnë mekanizma të fuqishëm për t'i trajtuar rastet e



dhunës, ngacmimeve dhe sulmeve seksuale", theksohet në reagimin e RrGK-së.

Mbahet takimi vjetor i Grupit të Përbashkët Punues Kosovë - Këshill i Evropës

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Nën organizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Këshillit të Evropës, të martën është mbajtur takimi i rregullt vjetor i Grupit të Përbashkët Punues. Punimet i hapi zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti, i cili tha se ky takim është i një rëndësie të veçantë, pasi është i pari takim pasi aplikimi i Kosovës u votua suksesshëm në Komitetin e Ministrave dhe u dërgua për opinion në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Para Grupit të Përbashkët Punues, zëvendësministri Ahmeti tha se procesi i aplikimit të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës dëshmon përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve të vendit për përmirësim në të gjitha shtyllat vitale të demokracisë, veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe lirisë së medieve. Zëvendësministri Ahmeti ka shprehur vlerësimin e institucioneve të Kosovës për Këshillin e Evropës dhe për



arritjet që kanë rezultuar nga ky Grup i Përbashkët Punues, që nga takimi i parë që u realizua në vitin 2013. Zëvendësministri Ahmeti ka përmendur arritjet që Kosova ka shënuar në dy vitet e fundit, duke u renditur e para në Evropë dhe e dyta globalisht në përmirësimin e sundimit të ligjit, përmirësimin për 20

pozita në renditjen e Transparency International për luftimin e korrupsionit, ngritje për 23 vende në Indeksin e Lirisë së Medieve dhe të tjera.

Ndërsa drejtori për Koordinim të Programeve të Këshillit të Evropës, Claus Neukrich, në fjalën e tij ka përmendur bashkëpunimin e mirë që ka

Këshilli i Evropës me institucionet e Kosovës dhe Zyrën e BE-së për realizimin e projekteve të përbashkëta në sektorin e drejtësisë, arsimit, luftës kundër korrupsionit, krimeve kibernetike dhe fusha të tjera me rëndësi. Ai shprehu gatishmërinë për ta vazhduar këtë bashkëpunim edhe në të ardhmen me qëllim

që të kemi sugjerime për vitin e ardhshëm sa i përket bashkëpunimit në mes të Këshillit Evropian dhe partnerëve në Kosovë. Takimi i Grupit të Përbashkët Punues është i tetëmbëdhjeti me radhë, ndërsa i pari që prej kur Republika e Kosovës ka filluar procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës.

Kosova më pak nxënës dhe studentë sesa një vit më parë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ka publikuar statistikën e arsimit për vitin shkollor 2022/2023.

Numri i fëmijëve në çerdhe dhe parashkollor për vitin shkollor 2022/2023 ishte 30 996 e që, krahasuar me vitin paraprak (2021/2022), që ishte 32 397 fëmijë, ka rënie të lehtë prej 1 401 fëmijëve.

Në sektorin publik në vitin shkollor 2022/2023 ishin 24 366 fëmijë ose 78,6 %, ndërsa në sektorin privat 6 630 fëmijë ose 21,4 %. Krahasuar me vitin



paraprak (2021/2022), në sektorin publik ishin 24 431 fëmijë ose 75,4 %, ndërsa në sektorin privat 7 966 fëmijë ose 24,6 %.

Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në vitin shkollor 2022/2023 ishte 220 578, prej tyre në sektorin publik ishin 212 967 ose 96,5 %

dhe në sektorin privat 7 611 ose 3,5 %. Krahasuar me vitin shkollor (2021/2022), ku numri i nxënësve ishte 224 429, prej tyre në sektorin publik ishin 217 977 ose 97,1 %, ndërsa në sektorin privat 6 452 ose 2,9 %. Nga kjo mund të shohim se sektori publik ka një rënie të numrit të përgjithshëm, kurse sektori privat ka një rritje të lehtë të numrit të nxënësve krahasuar me vitin 2021/2022.

Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në vitin 2022/2023 ishte 67 373, prej tyre në sektorin publik 63 029, ose 93,6 %, ndërsa në sektorin privat ishin 4 344 nxënës ose 6,4 %. Krahasuar me vitin paraprak 2021/2022 (që ishin 70 850 nxënës, në sektorin publik 67 138

ose 94,8 % dhe në sektorin privat 3 712 ose 5,3 %), ka rënie të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Rënie më e madhe vërehet te sektori publik krahasuar me sektorin privat. Numri i përgjithshëm i studentëve në arsimin e lartë në vitin 2022/2023 ishte 71 948, prej tyre në universitetet publike 40 996 studentë, ose 57 %, ndërsa në kolegjet private ishte 30 952 studentë, ose 43 %. Krahasuar me vitin paraprak 2021/2022 (që ishin 82 389 studentë, prej tyre në universitetet publike 50 188 studentë, ose shprehur në përqindje 60,9 %, ndërsa në kolegjet private ishte 32 201 studentë, ose 39,1 %, ka rënie të numrit të përgjithshëm të studentëve.

Mbahet punëtorja për zhvillimin ekonomik lokal

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale - KLGJ ka organizuar punëtorinë me komunat për të diskutuar për Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030. Qëllimi i punëtorisë ishte të ofrohen konsultime për komunat në fazën finale të hartimit të Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Ministria e Administrimit

të Pushtetit Lokal si dhe drejtorët e drejtorive për zhvillimin ekonomik lokal. Zhvillimi ekonomik lokal synon përmirësimin e jetës së qytetarëve duke inkurajuar rritjen e investimeve, stimulimin e ndërmarrjeve me potencial zhvillimi, promovimin e krijimit të vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e infrastrukturës për ta lehtësuar bashkëpunimin midis palëve. Programi Nacional për

Zhvillim Ekonomik Lokal 2030 është një dokument strategjik që ofron një qasje dykaheshe për zhvillimin ekonomik. Ky dokument paraqet objektivat strategjike të zhvillimit dhe një plan të politikave në nivelet qendrore dhe lokale me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm. Takimi kishte për qëllim adresimin e komenteve të fundit dhe diskutimin e sfidave që komunat hasin në zbatimin e dokumenteve strategjike siç



është Strategjia për Zhvillim Ekonomik. Aktiviteti realizohet në kuadrin e programit 'Dialogu për

Komunat Evropiane' (DEM), i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.

Menaxhimi i "Parkut Kombëtar" të Vjosës, plani do të sjellë disa kufizime në bujqësi dhe turizëm

TIRANË, 13 QERSHOR - Plani i menaxhimit të "Parkut Kombëtar" të Vjosës ka hyrë tashmë në fazën e dytë. Në këtë kohë po mbahen dëgjesa publike me banorë të luginës që laget nga Vjosa dhe degët e saj tashmë të mbrojtura.

Ekspertët janë duke tërhequr vëmendjen për një seri çështjesh me impakt për komunitetin si dhe janë duke hulumtuar për zgjidhje të qëndrueshme mbrojtjeje dhe zhvillim të parkut të vetëm lumor në Evropë. "Do të jemi gjatë gjithë luginës së Vjosës për ta parë potencialin turistik, për t'i parë shqetësimet ose kërkesat e komuniteteve që jetojnë përgjatë luginës së Vjosës dhe se si ata mund të përfitojnë nga 'Parku Kombëtar'", ka thënë Besjana Guri e Ecoalbania.

Takimet po sjellin në vëmendje rezultatet e planit të fizibilitetit për shtratin dhe katër prej degëve Bënçën, Drinon, Kardhiqin dhe Shushicën si dhe opinionin e ekspertëve sa iu përket kufijve të parkut në fazën e parë të mbrojtjes.

Plani i menaxhimit që po krijohet në funksion të zhvillimit synon lehtësi për aktivitetet në natyrë, rekreacion dhe turizëm të qëndrueshëm. Plani do të sjellë disa kufizime për bujqësinë, sidomos sa i përket përdorimit të pesticideve por përfitimet, sipas ekspertëve, do të jenë shumë më të mëdha se humbjet. "Jemi duke marrë dëgjësata publike me komunitetin, me bashkinë, me grupet e interesit dhe operatorët turistik të Vjosës dhe



duke bashkuar idetë e tyre dhe tonat do të hartohet plani për lumin", ka thënë Gligor Dushi, drejtor i Zonave të Mbrojtura. Andrej Sovinc, koordinator për planin, beson se ky është një lumë unik për Shqipërinë, Evropën dhe botën, sepse është një nga lumenjtë e fundit që rrjedhin të lirë në këtë pjesë të botës. "Kur flasim për plane zhvillimi kemi parasysh avantazhet për zhvillim të një lumi me cilësi fantastike kombinuar me resurse të tjera të zonës siç është trashëgimia kulturore dhe Gjirokastra e

mbrojtur nga UNESCO. Sigurisht në aspektin e përfitimeve për komunitetin do të ketë plane të detajuara shoqëruar me përmirësime në infrastrukturë, nxitje të ekoturizmit. Sigurisht do të ketë edhe aktivitete të ndaluara, por përfitimet prej parkut janë gjithnjë më të mëdha", ka thënë Sovinc. Qeveria e Shqipërisë e ka shpallur "Park Kombëtar" lumin Vjosa, që është lumi i fundit i egër në Evropë. Shpallja e lumit Vjosa "Park Kombëtar" nënkupton se nuk do të lejohet

asnjë ndërtim që cenon lumin, përfshirë këtu edhe hidrocentralet që kanë shkaktuar debat të madh në Shqipëri, por kanë sjellë edhe reagime të disa organizatave ndërkombëtare. Lumi Vjosa, i gjatë 270 kilometra, rrjedh nga shpatet e mbuluara me pyje të maleve të Pindit të Greqisë deri në bregdetin Adriatik të Shqipërisë. Shkencëtarët thonë se ekosistemi i Vjosës është habitat për 1100 specie, 13 prej të cilave janë në rrezik të madh të

zhdukjes. Vjosa, gjithashtu, ka vlerë ekologjike, kulturore dhe ekonomike për 60 000 shqiptarët që jetojnë në brigjet e saj. Shpallja e Vjosës "Park Kombëtar" ka qenë një nga fitoret më të mëdha të shoqërisë civile në Shqipëri. Vjosa, lumi i fundit i egër i Evropës, falë aktivizimit, u bë pjesë e një lobimi të madh edhe në nivel ndërkombëtar, fushatë që përfshiu edhe organizata të tilla si River Watch apo personalitete të mëdha të kulturës dhe artit.

Rritet qarkullimi i furnizimit me ujë, bie i asaj me rrymë

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat afatshkurtra të industrisë për muajin mars 2023. Në muajin mars 2023 indeksi i qarkullimit të industrisë kishte rritje më të madhe të furnizimit me ujë, veprimtaritë e menaxhimit dhe

trajtimit të mbeturinave me 1.22 %. Ndërkaq, rënia më e madhe ishte te furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar me (-0.33%), krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (mars 2022). Në muajin mars 2023 indeksi i numrit të të punësuarve kishte

rënie tek industria nxjerrëse (minierat dhe guroret) me (-0.12%), tek industria përpunuese me (-0.03%) dhe te furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (-0.01%), krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (mars 2022).



Muret e pathyeshme të Dubrovnikut



I vendosur përgjatë bregdetit të thyer të Adriatikut, qyteti i rrethuar me mure i Dubrovnikut në Kroaci, ka qenë prej kohësh një qendër kulturore dhe ekonomike në rajon. E megjithatë, ky qytet piktoresk ka përjetuar shumë konflikte dhe luftëra gjatë gjithë historisë së tij.

Muret aktuale të Dubrovnikut, datojnë kryesisht rreth shekullit XIV-të, por origjina e tyre është shumë më e vjetër. Besohet se ndërtimi i kalave të para me gurë gëlqerorë përreth qytetit, nisi në Mesjetën e Hershme në fund të shekullit VIII. Nga ai moment e tutje, Muret e Dubrovnikut u shtuan dhe u rindërtuan në mënyrë të përsëritur me kalimin e kohës kur u shfaqën kërcënime të reja.

Në shekujt IX dhe X, u ndërtuan mure për të mbrojtur pjesën lindore të qytetit. Kur Saraçenët (një popull arab) e sulmuan qytetin në shekullin IX-të, rrethimi zgjati 15 muaj, duke treguar se edhe në këtë periudhë të hershme qyteti ishte i mirë-fortifikuar.

Në shekullin XII-të, kanali detar që ndante qytetin nga pjesa kontinentale u mbush me dhe, dhe qyteti u bashkua

me vendbanimet e tjera në brendësi të tokës. Kjo çoi në shtimin e mureve origjinale, duke formuar një mur të vetëm rreth të gjithë zonës.

Këto mure relativisht të thjeshta u zgjeruan dhe përforcuan vazhdimisht, ndërsa Dubrovniku nisi të bëhej më i rëndësishëm si një qendër tregtare dhe një fuqi detare në rajon. Pjesa më e madhe e ndërtimeve ndodhi midis shekujve XIV-XV, e nxitur nga qyteti që fitoi pavarësinë e plotë nga venecianët.

Gjatë kësaj kohe, muret u zgjeruan për ta rrethuar të gjithë qytetin, ndërsa u shtuan kulla dhe fortesa të ndryshme. Edhe muret u përforcuan shumë, duke u bërë më të trashë. Ato i mbijetuan të paprekura tërmetit të vitit 1667, por edhe shumë rrethimeve nga ushtritë osmane në shekujt XVI-XVII.

Gjatë këtyre rrethimeve, mureve të jashtme iu shtua një lloj pjerrësie, e krijuar për të shmangur zjarrin nga topat e armikut. Në fakt, muret mbetën kryesisht të paprekura deri në Luftën Kroate për Pavarësi në vitet 1990, kur serbët e bombarduan rëndë qytetin. Muret përjetuan

dëmtime të mëdha, por që atëherë janë restauruar. Muret mbulojnë një zonë mbresëlënëse. Ata janë 1.940 metra të gjatë dhe deri në 25 metra të lartë. Trashësia e tyre ndryshon, por zakonisht është diku midis 4-6 metra. Janë ndërtuar kryesisht me gurë gëlqerorë vendas dhe nga gurgdhendës vendas.

Krahas vetë mureve, struktura mbrojtëse e qytetit paraqet disa kala të ndërtuara brenda vetë mureve. Pasi Kostandinopoja (Stambolli i sotëm) ra në duart e osmanëve në vitin 1453, për popullin e Dubrovnikut (ose Raguzës siç njihet atëherë) nevojiteshin më shumë struktura mbrojtëse.

Pas rënies së Bosnjës në vitin 1463, vendasit e ftuan arkitektin e famshëm nga Firenze Mikeloco di Bartolomeo për të drejtuar punën për fortifikimin e mureve mbrojtëse.

Osmanët e sulmuan Dubrovnikun disa herë gjatë historisë.

Më i madhi prej tyre ndodhi në vitin 1537, me një rrethim që zgjati disa muaj, dhe që u shoqërua me sulme të përsëritura. Në fund osmanët u tërhoqën dhe Dubrovniku

arriti të ruante pavarësinë e tij nga sundimi osman edhe për disa shekuj të tjerë.

Por edhe fitoret marrin fund një ditë. Në vitin 1806 në Dubrovnik mbërriti një flotë ruse, e cila kërkoi të përdorte portin për riparime dhe furnizim. Në atë kohë rusët ishin në luftë me francezët, dhe nga frika e hakmarrjes franceze, Dubrovniku refuzoi. Në kundërpërgjigje, rusët nisën një rrethim dhe bombarduan muret e qytetit me mbi 3000 gjyle topi, të cilat shkaktuan dëme të mëdha në qytet. Në fund, disa trupa arritën të hynin në qytet, duke e plaçkitur pasurinë e tij. Qytetarët iu drejtuar për ndihmë francezëve, të cilët i dhanë fund shpejt rrethimit rus dhe qyteti u shpëtua.

Ushtria franceze, e udhëhequr nga vetë Napoleon Bonaparti hyri në qytet në vitin 1806. Por shpëtimi nga francezët ishte një thikë me dy presa. Sepse në vitin 1808, Marshalli August Dë Marmo e shfuqizoi Republikën e Raguzës, dhe e bëri atë pjesë të provincave ilirike të Perandorisë Franceze, duke e shpallur veten "Duka i Raguzës".

Më pas në vitin 1814, qyteti u


rrethua dhe bombardua nga trupat austriake dhe angleze, derisa francezët që e drejtonin u dorëzuan. Sulmi më i fundit ndaj Mureve të Dubrovnikut, ndodhi gjatë Luftës Kroate për Pavarësi. Rrethimi nisi në tetor 1991, kur Ushtria Popullore Jugosllave (JNA) filloi një sulm masiv në Dubrovnik.

Me ndihmën edhe të forcave paraushtarake serbe, JNA shpresonte të pushtonte qytetin dhe të merrte kontrollin e një rajoni të rëndësishëm strategjik të Dalmacisë. Por mbrojtësit (kryesisht ushtarë kroatë dhe vullnetarë vendas) bënë një rezistencë të ashpër, por ishin të paktë të numër dhe të keq-armatosur.

Rrethimi zgjati disa muaj dhe muret e qytetit përjetuan bombardime dhe granatime të rënda. Shumë nga ndërtesat historike të qytetit, si pjesa e vjetër e qytetit, u dëmtuan rëndë ose u shkatërruan plotësisht. Shumë civilë u vranë ose u plagosën. Por një kundërsulm i kroatëve i dha fund rrethimit në mesin e vitit 1992.

Marrë me shkurtime nga ancient-origins – bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Klubet e inkuadruara në Superligë i ndajnë rrugët me trajnerët

Dy skuadrat e inkuadruara në Superligë, Feronikeli 74' dhe Liria, i kanë ndarë rrugët me trajnerët e tyre, Granit Begolli dhe Xhengis Rexhepi. Në ditët e ardhshme këto skuadra pritet të vendosin për pasardhësit e tyre

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 13 qershor - Feronikeli 74' nga Drenasi dhe Liria e Prizrenit në edicionin 2023/2024 do të bëjnë gara në Superligë, por nuk do të drejtohen nga trajnerët që i rikthyen në elitën e futbollit të Kosovës, Granit Begolli dhe Xhengis Rexhepi.

Trajneri Granit Begolli në "Facebook" ka njoftuar për ndarjen me klubin nga Drenasi, ani pse drejtuesit e kësaj skuadre ishin të interesuar për ta vazhduar bashkëpunimin edhe për edicionin e ri. "Ju

njoftoj se nuk do të jem më pjesë e Feronikelit 74'. Kam vendosur të largohem nga klubi pavarësisht se më është ofruar mundësia ta drejtoj skuadrën në Superligë. E falënderoj kryetarin e komunës, Ramiz Lladrovci, për përkrahjen gjatë gjithë sezonit, presidentin Erlind Krasniqi për mundësinë që ta drejtoj klubin drejt Superligës, ku së bashku arritëm objektivin pas një sezoni me shumë vështirësi", ka thënë Begolli, i cili i ka falënderuar edhe tifozët, stafin e trajnerëve, tifozët, kapitenin Lapidar Lladrovci dhe të gjithë njerëzit e tjerë që punuan në klub.

Të martën ndarjen me trajnerin Xhengis Rexhepi e konfirmoi edhe skuadra e Lirisë.

Klubi prizrenas nuk e ka përjashtuar mundësinë që sërisht të bashkohen në të ardhmen me trajnerin që e riktheu në elitë pas katër vjetësh. "Me inkuadrimin në Superligë, Liria dhe trajneri Xhengis Rexhepi i kanë ndarë rrugët. Kontrata e klubit me trajnerin ka qenë deri në përfundim të stinorit, që zyrtarët e vlerësojnë të suksesshëm. Klubi e falënderon për punën profesionale dhe suksesin e arritur. 'Po ndahemi me marrëveshje të dyanshme, dhe me bindjen që kjo nuk është



lamtumirë. Dera për trajnerin Xhengis Rexhepi do të jetë e hapur gjithmonë", thonë drejtues të Lirisë. Klubi i dëshiron suksese në vazhdim,

duke e falënderuar në emër të tifozëve e adhuruesve anekënd, për punën dhe suksesin e treguar", thuhet në njoftimin e Lirisë.

Kurti: Politika, ndryshe nga sporti, është lojë pa rregulla



Prizren, 13 qershor - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka cilësuar politikën si një "lojë pa rregulla" në të cilën kushdo e kurdo mund të thotë se "dua të luaj edhe unë", gjë kjo e cila nuk ndodh në sport. Ai ka deklaruar kështu në qytetin e Prizrenit, ku po mbahet tryeza e katërt e sportit dhe ku po paraqitet drafti i projektligjit për sportin, si dhe strategjia për sportin. Duke folur për zhvillimin e sportit në Kosovë, për të cilin i pari i ekzekutivit ka

thënë se po bëhet punë e madhe dhe sukseset nuk po mungojnë, Kurti shtoi se kohën e fundit po i përdor ngjarjet sportive për t'u çliruar nga stresi që po ia krijon marrja me politikë. "Dua t'ua zbuloj një sekret. Në muajt e fundit jam duke i përdorur ngjarjet e sportit për t'u çliruar nga stresi i madh që sjellin zhvillimet politike. Kur dal në mbërmbje me Daulina Osmanin e Hajrulla Çekun në ndonjë ndeshje nga sportet e ndryshme, shoh se si në sport ka

rregulla që respektohen në përpikëri, madje kur dyshohet për gabime, shikohen xhirimet. Në politikë nuk po funksionon kështu. Aty, nëse kur je duke luajtur, vjen dikush e të thotë 'edhe unë jam duke luajtur e nuk jam vetëm shikues'", ka thënë Kurti. Ai kërkoi nga të gjitha organizatat sportive në vend mobilizim të madh për t'u bërë gati për Lojërat Mesdhetare të cilat Kosova synon t'i organizojë në vitin 2030.

Curri: Emërimi trajner i Prishtinës, privilegj për mua

Prishtinë, 13 qershor - Debatik Curri është emëruar trajner i FC Prishtina. Lajmin e ka dhënë të martën skuadra kryeqytetase në faqen zyrtare. "Ish-futbollisti ynë, që nga kategoritë e reja si lojtar kishte fituar titullin e kampionit, kurse trofeun e Kupës e arriti si ushtrues detyre i kryetrajnerit. Curri, 39 vjeç, futbollist me përvojë të madhe ndërkombëtare, trajner i

skuadrës që nga viti 2018, i ka bindur krerët e klubit për t'ia dhënë përgjegjësinë e madhe që edhe zyrtarisht t'i prijë skuadrës më të madhe në vend", thuhet në njoftimin e FC Prishtina. Skuadra kryeqytetase, pas triumfit në garën e Kupës nën udhëheqjen e Currit, vendosi t'ia besojë pozitën e trajnerit. Curri ka deklaruar se emërimi



në këtë pozitë është privilegj. Ai ka premtuar se do të punojë fuqishëm për t'i sjellë skuadrës suksese të reja. "Jam shumë i

lumtur për vazhdimin e bashkëpunimit me klubin e zemrës, FC Prishtina. Vendimin për emërimin kryetrajner e vlerësoj jashtëzakonisht shumë. Është privilegj për mua. Më jep përgjegjësi të vazhdoj t'i ushroj detyrat e mia të plota që këto suksese t'i përsëris edhe në edicionin e ri. Objektivat e skuadrës janë të qarta. Ekipi ka shumë futbollistë të rinj të

talentuar që do të jenë shtylla kryesore e skuadrës. Pres që klubi në ditët në vazhdim do të m'i ofrojë edhe futbollistët që kam planifikuar t'i kem për sezonin e ri. Dua t'i falënderoj udhëheqësit e klubit dhe drejtorin sportiv Driton Krasniqi për besimin e dhënë. Jam i bindur se do ta vazhdoj rrugën e lavdishme të një klubi siç është Prishtina", ka deklaruar Curri.

Zyrtare: Munishi, trajner i Ferizajt

FERIZAJ, 13 QERSHOR - Skuadra që ka rënë nga Superliga, FC Ferizaj, e ka përmbyllur me sukses marrëveshjen me trajnerin e njohur kosovar Ismet Munishi. Marrëveshja mes skuadrës së Ferizajt dhe Munishit është dyvjeçare. "FC Ferizaj, pavarësisht që do të

garojë në Ligën e Parë, jam i bindur se do të funksionojë me logjikën e një klubi kampion të Superligës. Projekti është shumë serioz. Ne e synojmë jo vetëm Superligën, por edhe Evropën në një periudhë të afërt", ka thënë Munishi. Strategu kryeqytetas ka një

bagazh të madh si lojtar dhe trajner. Si lojtar ka mbrojtur ngjyrat e skuadrave të mëdha sllovene, Maribor, Mura 05, Olimpija Lubljana, ndërsa ka luajtur edhe në Sekerspor, Maccabi Herzilya dhe skuadrën e njohur ukrainase Vorskla Poltava. Si trajner ka udhëhequr

ekipin kampion të Llamkos Vushtrrisë. Sukseset i ka vazhduar edhe në KF Ballkanin dhe SC Gjilanin, duke i vendosur gurëthemelet e këtyre ekipeve që sot luajnë në Evropë. Munishi ka drejtuar edhe Dritën, Prishtinën dhe Feronikelin.



Tre sportistë të rinj iu shtuan listës së bursistëve ‘Shpresa Olimpike 2023’

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Bordi Ekzekutiv i KOK-ut, nën udhëheqjen e presidentit Ismet Krasniqi, ka mbajtur mbledhjen e 26, në të cilën janë shqyrtuar pika të ndryshme të rendit të ditës. Me këtë rast, BE aprovoi propozimin e komisionit të sportit për përzgjedhjen edhe të

tre bursistëve të rinj “Shpresa Olimpike 2023”. Janë këta Edonit Telaku (shenjëtari sportive), Blin Kuka (xhudo) dhe Sylejman Vizdiklar (taekwondo), të cilët e quan në 35 numrin e sportistëve të rinj, të cilët mbështeten me bursa mujore nga KOK-u për vitin 2023.

BE diskutoi edhe çështje të tjera me rëndësi si: Strategjia e KOK-ut, përzgjedhja e logos për kandidaturën për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030 dhe çështje të tjera. Sa iu përket kërkesave për rekomandim të shpërblimeve në Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport, bazuar në

rezultatet kulminante, BE aprovoi kërkesën për sportistin e bodybuildingut, Betim Krasniqi, nënkampion Evropë, ndërsa u refuzua kërkesa e Kushtrim Bajraktaraj, kampion Evropë, për shkak të mosplotësimit të kriterëve të garuesve në kategori.



Mbappe dhe PSG-ja, afër ‘divorcit’

PARIS, 13 QERSHOR - Lajmi që Kylian Mbappe i ka komunikuar klubit të PSG-së që nuk do ta aktivizojë rinovimin automatik të tij edhe për një sezon tjetër siç e parashikon kontrata aktuale, ka bërë shumë zhurmë dhe tashmë duket si një betejë e rihapur mes dy palëve. PSG-ja ia bëri të qartë francezit që nëse ai nuk aktivizon rinovimin automatik deri më 1 gusht, atëherë ai do të jetë menjëherë në merkaton e verës, për të pritur oferta rreth tij, pasi normalisht klubi francez nuk mund të humbasë kursesi një lojtar si ai me parametra zero. Nëse kjo gjë ndodh, pra nëse Mbappe del në merkato, padyshim që klubi i parë që do të futej në garë do të ishte pikërisht Real Madridi. “Los Blancos” ka kohë që e ka dashur në ekip francez, sidomos verën e kaluar ishin shumë pranë transferimit të tij, por gjërat morën tjetër ujëra në çastet e fundit. Megjithatë, nuk dihet nëse Real Madridi do të tentonte për transferimin e Mbappes, pasi



tashmë sapo ka mbyllur një transferim të kushtueshëm, atë të Jude Bellinghamit nga Dortmund. Një tjetër rrugë alternative mund të jetë Premierë Liga, me Liverpoolin dhe Manchester Unitedin, të cilët kanë qenë shumë të përfshirë në rastin e tij në vitet e mëparshme dhe do ta bënin këtë gjë përsëri. Ndoshta Liverpooli jo, pasi është i fokusuar në radhë të parë në rikonstruksionimin e mesfushës. Unitedi mund ta bënte një tentativë, por gjithmonë nëse në

krye të klubit do të vinte sheiku i cili po tenton ta blejë klubin nga familja Glazers, dhe Mbappe mund të ishte goditja e tij e parë në merkato e cila do të mbahej mend shumë gjatë. Nga ana tjetër, në sfond ndodhet edhe Chelsea me Manchester Cityn. Nëse PSG-ja në fund vendos në vitrinë Mbappen, atëherë me siguri do ta kërkojë shumën më të lartë të mundshme, të paktën për ta barazuar çmimin që e bleu në vitin 2018 nga Monaco për 180 milionë euro.

Denveri shpallet kampion për herë të parë në NBA

DENVER, 13 QERSHOR - Ëndrra më në fund u bë realitet. Ekipi i Denver Nuggetsit u shpall kampion i NBA-së për sezonin 2022-2023, duke mundur 4-1 me ndeshje Miami Heat. Kampionët e Perëndimit fituan me rezultat 94-89 ndeshjen e pestë finale luajtur në fushën e tyre, duke korrur suksesin më të madh në historinë e tyre. Për Denverin ky është titulli i parë kampion në NBA. Basketbollisti Nikola Jokiq, që në këtë ndeshje realizoi 28 pikë e 16 rebounde, u shpall më i miri i finaleve, njeriu që udhëhoqi skuadrën drejt një triumfi të madh. Ndeshja e fundit nuk ishte spektakolare, por kjo kuptohej duke parë se luhej për titullin kampion në NBA. Dhe Denveri nuk zhgënjeu edhe pse e nisi keq takimin. Përveç Jokiqit, u dalluan edhe Porteri me 16 pikë e 13 rebounde si dhe Murray me 14 pikë. Për Miamin, Butleri realizoi 21 pikë e Adebayo 20 pikë e 12 rebounde, por që mbetën për statistikë. Pas triumfit, në fushë nis



festa, jo vetëm për lojtarët e Denverit, por edhe për tifozët, ndërkohë që mijëra njerëz mbushin rrugët e qytetit për ta

festuar këtë titull. Një festë që e kishin ëndërruar për dekada me radhë dhe që më në fund bëhet realitet.

SHKURT

Trajneri i Moldavisë: Shkojmë për fitore në Tiranë

Trajneri i Moldavisë, Serghei Clescenco, shprehet se ekipi i tij është i gatshëm dhe kërkon fitoren pasi, sipas tij, e ka studiuar mirë kombëtaren tonë ‘kuqezi’ dhe i njeh pikat e dobëta. Shqipëria do të përballlet me Moldavinë dhe Ishujt Faroe në kuadër të Grupit E për kualifikueset për Kampionatin Evropian.

Kombëtarja shqiptare më 17 qershor i pret moldavët në “Air Albania”. Përpara këtij takimi foli edhe trajneri i Moldavisë, Clescenco, i cili tha se udhëtojnë në Shqipëri për të marrë fitore. “Kemi një skuadër të re. Sigurisht lojtarët vijnë në këtë grumbullim pak të lodhur dhe duhet ta marrin veten nga një sezon të gjatë e të vështirë. Ka elementë të rinj. Shkojmë për ta bërë surprizën dhe për të marrë një fitore në Shqipëri. Djemtë janë të gatshëm. E kam analizuar ndeshjen e Shqipërisë në Poloni. Them se ka pika të dobëta ku ne mund t’i godasim dhe të fitojmë. Nuk shkojmë si të humbur në Tiranë. Mobilizimi ynë do të jetë maksimal dhe shpresojmë shumë në një rezultat pozitiv”, ka deklaruar trajneri i Moldavisë.

De Ligt mungon ndaj Kroacisë

Trajneri i Kombëtares së Holandës, Ronald Koeman, ka marrë një lajm të keq në prag të gjysmëfinaleve të Ligës së Kombeve kundër Kroacisë. Mbrojtësi i Bayern Munchenit, Matthijs de Ligt, është dëmtuar gjatë stërvitjes të së shtunës dhe, siç është komunikuar nga federata holandeze, ai nuk do të jetë në ndeshjet e ardhshme. Për ta zëvendësuar është thirrur Daley Blind.

Zidane: Nuk është koha të bëhem trajner i Francës

Zinedine Zidane thyen heshtjen, flet për disa nga opsionet e lakuara në media, ku temë kryesore mbetet mundësia për ta drejtuar përfaqësuesen franceze. “E kam thënë gjithnjë, kur e njeh Francën si lojtar, më pas kur bëhesh trajner është logjike të mendosh që një ditë mund ta drejtosh, por nuk është koha. Kam qenë gjithnjë ambicioz. Kur luaja për Cannes dëshiroja të shkoja te Bordeaux. Më pas dëshiroja të luaja te Juventus, më pas te Real Madridi. Gjithnjë kam besuar në veten time”, ka thënë Zidane. “Një rikthim tjetër te Real Madridi? Unë nuk i programoj gjërat, bëj atë që ndiej. Në fillim kalova dy vjet gjysmë te Reali, fituam gjithçka, më pas mora një pushim. Pas tetë muajsh presidenti Perez më mori në telefon dhe u riktheva menjëherë. Gjithmonë më shoqëronte një mundim: Pse duhet të rikthehem pas asaj që kisha bërë? Përse të rrezikoj që të bëja më pak mirë? Por kështu është, shpesh rrezikoj në mënyrë instiktive”, u shpreh Zidane.

Kimmich, besnik i Bayernit

Zëvendëskapiteni i Bayern Munchenit, Joshua Kimmich, nuk është i interesuar për të ndryshuar skuadër, ani pse ofertat për të nuk po mungojnë. “Në përgjithësi nuk jam shumë i përfshirë në thashethemet e tregut të transferimeve. Siç e dinë të gjithë, kam ende dy vjet në kontratën time. Po kështu kemi plane të mëdha me Bayern Munchenin”, ka thënë Kimmich për gazetën “Bild”. Barcelona është skuadra kryesore që interesohet për reprezentuesin gjerman, i cili shihet si një zëvendësues ideal për mesfushorin Sergio Busquets.

Guardiola i dëshiron dy futbollistët e Kroacisë

Pep Guardiola arriti të shpallet kampion me Manchester Cityn në Ligën e Kampionëve, derisa kampion është edhe në Premierë Ligë dhe fitues i Kupës. Tash

trajneri spanjoll ka filluar të mendojë për sezonin e ri, por është i vendosur ta përforcojë skuadrën. Fjala është për dy futbollistë kroatë. Mateo

Kovačić, i cili edhe vetë nuk e ka refuzuar mundësinë për t’u transferuar te City, ka nisur bisedimet për të bërë të mundur këtë lëvizje. Ai shihet si

mesfushori ideal nga Guardiola për të bërë një hap më shumë në lojën e skuadrës. Objektivi tjetër vjen në mbrojtje. Bëhet fjalë për mbrojtësin kroat Josko Gvardiol.

Ky i fundit ka zhvilluar një botëror fantastik me Kombëtaren e Kroacisë, por edhe me Leipzigun, dhe Guardiola e kërkon me çdo kusht në skuadër.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e 1 (një) anëtar/e në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108 paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (për përfaqësuesit e komunitetit serb) nga radhët e gjyqtarëve

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 06/L -055 për Këshillin Gjyqësor të Republikës Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit kushtetues dhe ligjor për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës,

Kuvendi rishpall konkurs për plotësimin e pozitës:

1 (një) anëtar/e, siç përcaktohet me nenin 108 paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (për përfaqësuesit e komunitetit serb) nga radhët e gjyqtarëve.

Kandidati për anëtar në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, duhet t' i plotësojë kushtet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, dhe aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia së është emëruar gjyqtar me mandat të përhershëm;
- Dëshmia se ndaj ti nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 3 korrik 2023, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:

Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo ponovo raspisuje:

K O N K U R S

Za izbor 1 (jednog) člana Sudskog saveta Kosova, u skladu sa članom 108. stav 6. pod stav 3. Ustava Republike Kosovo (za predstavnike srpske zajednice) iz reda sudija

U skladu sa članom 10. Zakona br. 06/L-055 o Sudskom savetu Republike Kosovo i u cilju ispunjenja ustavne i zakonske obaveze izbora članova Sudskog saveta Republike Kosovo,

Skupština ponovo raspisuje konkurs za popunjavanje radnog mesta:

1 (jedan) član, kako je definisano članom 108. stav 6. pod stav 3. Ustava Republike Kosovo (za predstavnike srpske zajednice) iz reda sudija.

Kandidat za člana Sudskog saveta Republike Kosovo mora da ispunjava uslove utvrđene Ustavom i Zakonom o Sudskom savetu, a uz prijavu moraju biti priloženi sledeći dokumenti:

- Autobiografija (Curriculum vitae);
- Dokaz o imenovanju za sudiju sa stalnim mandatom;
- Dokaz da vam nije izrečena disciplinska mera.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije dostaviti najkasnije do 3. jula 2023. godine do 16.00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikaciju možete uzeti u:

Štampanoj formi: na recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

Elektronskoj formi: internet–stranica Skupštine Republike Kosovo - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz zahtevana dokumenta.

Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L.-212, të Republikës Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4 dhe 5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë, vendimin nr.1966 të datës 12.06.2023,, NPK."Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më date 12.06.2023 shpall:

K O N K U R S

Pozita e punës: Pastrues Autobusi

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit, me mundësi vazhdimi.

Niveli i pagës: XXII.

Numri i pozitave: 5 pozita.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Bën pastrimin dhe larjen e autobusëve dhe automjeteve tjera zyrtare të ndërmarrjes brenda dhe jashtë;
- Pastrimi bëhet sipas planit operativ të hartuar nga përgjegjësi;
- Pastron pjesët e brendshme të autobusëve dhe veturave zyrtare nga mbeturinat dhe pluhuri sipas rendit kronologjik që vijnë ata në vendin e caktuar për pastrim;
- Pastrimi i autobusëve bëhet çdo ditë brenda dhe me spërkatje me ujë jashtë autobusit;
- Ditëve të vikendit të shtunave dhe të dielave bëhet pastrimi gjeneral i autobusëve;
- Pastrimi bëhet me kujdes që mos të dëmtohen kamerat dhe pajisjet tjera elektronike Për çdo prishje të pajisjeve elektronike të shkaktuar nga mos kujdesi gjatë larjes, mbani përgjegjësi – shpenzimet për eliminim të defektit i bartë vet punëtori;
- Mbanë përgjegjësinë e humbjeve, dëmtimeve të pajisjeve të punë gjatë ndërrimit dhe ruajtjen e tyre, që të mos vijë deri te dëmtimi, thyerja e tyre, apo ndodhje të vjedhja gjatë orarit të punës;
- Në rast të mungesës se zyrtarëve tjerë me urdhër të udhëheqësit të sektorit mund t'i zëvendësojë dhe të kryen detyrat tjera;
- Për shkak të specifikave të punës, veprimtaria për kryerjen e këtyre punëve zhvillohet gjatë ndërrimit të dytë dhe tretë;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga mbikëqyrësi;
- Për punën e tij i përgjigjet Përgjegjësit të Autolarjes.

Përgatitja profesionale

- Shkolla e mesme 1 vit përvojë pune
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

Dokumentacioni i kërkuar:

-Kandidati/ja, duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>);
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust.
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes e-mailit : punesimi@trafikurban-pr.com.

Konkursi është i hapur nga data **14.06.2023** dhe përfundon më datë **28.06.2023** në ora **24:00**.



Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03/L.-212, Republike Kosovo, član 4 tačke 1, 2, 3, 4 i 5 i član 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a) član 10 tačka 1,5 i 11 tačka 1 Uredbe br.1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima, odluka br.1966 od 12.06.2023.godine, NPK "Urbani saobraćaj" SHA.- Priština, od 12.20.2017. :

JAVNI KONKURS

Radno mesto: Čistač autobusa

Trajanje ugovora: 1 godina, sa mogućnošću produženja.

Nivo plata: XXII.

Broj pozicija: 5 pozicija.

Dužnosti i odgovornosti:

- Čisti i pere autobuse i druga službena vozila iznutra i spolja;
- Čišćenje se vrši prema operativnom planu koji je izradio odgovorni;
- Čisti unutrašnje delove službenih autobusa i automobila od otpadaka i prašine po hronološkom redosledu dolaska na predviđeno mesto radi čišćenja;
- Autobusi se svakodnevno čiste unutar i prskanjem vode izvan autobusa;
- Vikendom, subotom i nedeljom vrši se generalno čišćenje autobusa;
- Čišćenje se vrši pažljivo kako se ne bi oštetile kamere i drugi elektronski uređaji. Za svaki kvar elektronskih uređaja izazvan nepažnjom tokom pranja snosite odgovornost - troškove otklanjanja kvara snosi sam radnik;
- snosi odgovornost za gubitke, oštećenja opreme za rad prilikom njihove zamene i skladištenja, tako da se ne oštete, pokvarc ili ukradu tokom radnog vremena;
- U odsustvu drugih službenika, po nalogu načelnika sektora, može ih zameniti i obavljati druge poslove;
- Zbog specifičnosti posla, aktivnost za obavljanje ovih poslova odvija se u drugoj i trećoj smeni;
- Obavlja poslove i druge poslove u vezi sa opisom poslova koje zahteva rukovodilac;
- Za svoj rad odgovara rukovodiocu autopraonice.

Stručna priprema

- Srednja škola 1 godina radnog iskustva
- Dobre organizacione i komunikacione veštine;
- Profesionalna etika i sposobnost rada pod pritiskom;

Potrebna dokumentacija:

- Kandidat, ove dokumente moram dostaviti u skeniranom obliku na mejl: punesimi@trafikurban-pr.com:

- Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <http://www.trafikurban-pr.com/shk/job-aplikacioni-shk.html>);
- Dokaz o obrazovanju;
- Kopija lične karte;
- Dokaz o dokazanom radnom iskustvu sa Trustom.
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
- Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

Način primenc:

Prijava se može izvršiti samo putem e-maila: punesimi@trafikurban-pr.com.

Konkurs je otvoren od 14.06.2023 i završava se 28.06.2023 u ponoć.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPI PER ARMI SH.A - VUSHTRRI
Nr: Protokollit: 713/23
Data: 13.06.23

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtrri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A, lidhur me nenin 16 nën par. 1.6.2 të Rregullores Nr. 35/23 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A, i miratuar me datë 06.05.2023 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A e duke u bazuar në vendimin me nr. 595/23 të Kryeshefit Ekzekutiv të marr me datë 22.05.2023, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 23.05.2023 shpall:

KONKURS PUBLIK

1. Titulli: Mirëmbajtës i Hapësirave Publike

Numri i ekzekutuesve: 6

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar gjashtë (6) muaj, nga të cilat tre (3) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes së Hapësirave Publike

Koeficienti i pagës: 4.35

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset për ruajtjen, pastrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve të qytetit.
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rrethojave të parqeve.
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e inventarit për rekreacion dhe pushim në parqe.
- Kujdeset për mirëmbajtjen e stazave dhe gjelbërimit në parqe.
- Mbjell, kultivon lule dhe bari, si dhe kositë dhe rregullon ato, duke përfshirë ujitjen dhe freskimin.
- Kultivon, mirëmban dhe krasitë drunjtë në pronësi publike.
- Mban higjienën dhe pastrimin e parqeve dhe shesheve.
- Bën hapjen e varrezave.
 - Kujdeset për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, martirëve, lapidarëve, përmendoreve, pllakave përkujtimore, të cilat menaxhohen nga komuna.
 - Bën fshirjen e oxhaqeve në objektet publike dhe private, në bazë të tarifave të përcaktuara paraprakisht.
 - Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes së Hapësirave Publike.
 - Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetim dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Dëshmitë për përvojën e punës (Nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 24.05.2023 deri me datë 07.06.2023 në ora 16:00.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPI PER ARMI SH.A - VUSHTRRI
Nr: Protokollit: 713/23
Data: 13.06.23

Na osnovo člana 8, člana 10, stav 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o Radu objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosova od 01.12.2010. godine, u vezi sa članom 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o Regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o Radu, objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosova od 31.10.2017. godine, članom 11, članom 21, stav 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o Radnom odnosu N.P.L "Përparimi" Sh. A u Vučitrnu, koji je usvojen dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora N.P.L "Përparimi" Sh. A, u vezi sa članom 16, stavom 1.6.2 Pravilnika br. 35/23 o Internoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta N.P.L "Përparimi" Sh. A, koji je usvojen dana 06.05.2023. godine od strane Upravnog odbora N.P.L "Përparimi" Sh. A, a na osnovu odluke broj 595/23 Izvršnog direktora dana 22.05.2023, N.P.L "Përparimi" Š. A od 23.05.2023 saopštava:

JAVNI KONKURS

1. Naziv: Održavalac javnih prostora

Broj izvršilaca: 6

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Period zaposlenja: Određeno vreme, šest (6) meseci, od kojih će tri (3) meseca biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna sprema: Osnovna škola

Radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo

Podređenost: Rukovodiocu Jedinice za održavanje javnih prostora

Koeficijent plate: 4.35

Opis poslova i odgovornosti:

- Brine o očuvanju, čišćenju i održavanju gradskih parkova.
- Brine o očuvanju i održavanju ograde parkova.
- Brine o očuvanju i održavanju inventara za rekreaciju i odmor u parkovima.
- Brine o održavanju staza i zelenih površina u parkovima.
- Sadnja, gajenje cveća i biljaka, kao i košenje i uređivanje istih, uključujući zalivanje i osvežavanje.
- Gaji, održava i uređuje drveće na javnom vlasništvu.
- Održava higijenu i čistoću parkova i trgova.
- Vršiti otvaranje grobnica.
- Brine o održavanju grobnica za heroje, mučenike, spomenike, memorijalne ploče, koje upravlja lokalna samouprava.
- Vršiti čišćenje jama na javnim i privatnim objektima, na osnovu unapred utvrđenih tarifa.
- Za svoj rad odgovara Rukovodiocu Jedinice za održavanje javnih prostora.
- Vršiti i druge poslove po nalogu uprave preduzeća.

Potrebno priložiti uz prijavu:

- Prijava za zapošljavanje NP "Përparimi" Sh. A - Vučitrn.
- Dokaz o kvalifikaciji (diploma overena kod notara).
- Izvod iz matične knjige rođenih (original).
- Potvrda suda kojom se potvrđuje da nije pod istragom i koja se dostavlja u originalnom obliku (ne starije od 6 meseci).
- Dokazi o radnom iskustvu (nije obavezno).
- Kopija lične karte.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja istog. Zainteresovani kandidati mogu preuzeti i dostaviti prijavi formular u Arhivskoj kancelariji NP "Përparimi" Sh. A u Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" br. 82, (bivši objekat TMK-a pored Osnovnog suda Mitrovica - odeljenje u Vučitrnu), svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji se prijavljuju trebaju tačno navesti adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 24.05.2023. do 07.06.2023. do 16:00 časova.

N.P.L "Përparimi" Sh. A u Vučitrnu pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosova. Za dodatne informacije možete kontaktirati na broj telefona 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave koje se dostave nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene, dok nepotpune prijave će biti odbijene."



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriaz" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjbiznesi.com,
info@kolegjbiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **26.05.2023**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

KONKURSI PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK 19.06.2023 deri më 12.07.2023

I. PROFESOR

1.	Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	MENAXHMENT DHE EKONOMIKS - BA
2.	Dy (3) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	JURIDIK LLB
3.	Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	MENAXHIMI I EMERGJENCAVE - BA
4.	Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	BANKA DHE FINANCA NË BIZNES - BA
5.	Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	MENAXHMENT DHE FINANCA - MA

II. ASISTENT

1. Një (1) asistent për lëndë ekonomike,
2. Një (1) asistent për lëndë juridike,
3. Një (1) asistent për lëndë të emergjencave,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të **Kolegjit Biznesi**.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Për vendin e punës asistent, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar studimet Master në lëmin përkatëse, preferohet të kenë të regjistruar studimet e doktoratës (PhD).

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Diplomat origjinale Ose kopjet e diplomave (baçelor, master, magjistaturë dhe doktoratë) të vërtetuara nga noteri; Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet Master jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **19.06.2023 deri më 12.07.2023**.

Paraqitja e dokumenteve: Rr.Motrat Qiriaz 29, 10000 Prishtinë, Kosovë dhe përmes e-mail: info@kolegjbiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjbiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjbiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

